20 prot

VITI MBAREKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEUT - 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE**
**DREJTORIA E PRIVATIZIMIT**

Nr. 19039 Prot. Tiranë, më 25.10.2018

# URDHËR

**Nr. 287 datë 25.10.2018**

## PËR
## BASHKIMIN ME SHOQËRINË "PETROL ALBA" SH.A. NË LIKUIDIM, ME ANË TË PËRTHITHJES TË SHOQËRISË "SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" SH.A. NË LIKUIDIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar dhe nenit 191, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm,

**URDHËROJ:**

1. Bashkimin me shoqërinë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim, me anë të përthithjes të shoqërisë "Shpërndarja e Librit Shkollor" sh.a. në likuidim.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit, sipas përcaktimeve të nenit 216 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar.
3. Eksperti Kontabël i Autorizuar Znj. Vullnetare Çela, të hartojë raportin përkatës, sipas përcaktimeve të nenit 217 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar.
4. Shoqëria "Shpërndarja e Librit Shkollor" sh.a. në likuidim, pas përfundimit të bashkimit, referuar nenit 220 të të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar, vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga QKB-ja, sipas seksionit V të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Komandohet Znj. Nermin Bardulla, aktualisht juriste e shoqërisë "Shpërndarja e Librit Shkollor" sh.a. në likuidim, të kryejë funksionet e likuidatorit të shoqërisë, deri në përfundimin e procedurave të bashkimit.

Bledar Ahmeti

6. Përfundimi i marrëdhënieve të punës për punonjësit e shoqërisë "Shpërndarja e Librit Shkollor" sh.a. në likuidim, në përfundim të procedurave të bashkimit, të bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.
7. Ngarkohen shoqëritë "Petrol Alba" sh.a. në likuidim dhe "Shpërndarja e Librit Shkollor" sh.a. në likuidim, për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**

MINISTRIA ... DHE EKONOMISË TIRANË

Bledar Ahmeti

MARVESHJA E BASHKIMIT
"RAPORTI I LIKUJDATOREVE PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERISE"
"Shperndarjes se "Librit Shkollor"sh.a. nga Shoqeria "Petrol Alba" sh.a.

- **Shoqëria përthithëse "PETROL ALBA" sh.a.,** me kapital te nënshkruar 2,651,973,000 Lekë, qe zoterohet nga ortaku i vetem shtet Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikeş sot Ministria e Finances dhe Ekonomise, qe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 100% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie,
- **Shoqëria e përthithur "Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** me kapital te nënshkruar 225,452,000 Lekë, qe zoterohet nga ortaku i vetem shtet, Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise, qe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 100% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie.

Shoqëria **"PETROL ALBA" sh.a.** dhe shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** kane bere marrëveshje për t'u bashkuar ne një shoqëri te vetme, bashkim i cili do te behet me përthithje, prandaj mbështetur në dispozitat e Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", likujdatoret e shoqërive respektive përgatisin këtë raport për të detajuar bashkimin e shoqërive për ta paraqitur këtë pranë QKB.

1. Shoqëria **"PETROL ALBA" sh.a.**

Shoqëria **"PETROL ALBA" sh.a.,** me adrese : Rruga e "Kavajës", Godinë e Ndërmarrjes "Industriale Nr.1", Tirane, Shqiperi, me NUIS (NIPT) K81706001 7T, me objekt te ushtrimit te veprimtarisë magazinimin, tregtimin me shumice dhe pakice te karburanteve dhe nenprodukteve te tyre, etj me likujdator z. Gentjan Dalipaj.

Shoqëria është krijuar me 06/05/2008 me kapital themeltar 2,651,973,000 (dymilardeegjashteqindepesedhjetenjemilionenenteqindeshtatedhjeteetremije) Lekë. Kohëzgjatja e veprimtarisë sipas aktit të themelimit dhe statutit është pa afat.

Shoqëria ka një personel prej 54 (pesedhjete e kater) punonjësish ne daten e bashkimit, qe perbehet nga administratori i saj dhe 53 (pesedhjeteetre) te punesuar.

Kapitalet e veta te shoqërise **"PETROL ALBA" sh.a.** jane në vlerën **1,755,677,590** Lekë.

Kapitali i shoqërisë **"PETROL ALBA" sh.a.** zotërohet 100% nga METT sot Ministria e Finances dhe Ekonomise ortak i vetem.
Shoqëria **"PETROL ALBA" sh.a.** ushtron aktivitet qe prej vitit 2008. Per kete periudhe shoqeria ka pasur rezultat negativ, kjo si pasoje se shoqeria eshte nje shoqeri ne likujdim. Në vitin ushtrimor 2017, shoqëria **"PETROL ALBA" sh.a.** ka rezultuar me një humbje tregtare në vlerën **-296,243,967** Lekë. Per vitin 2018 shoqeria ka regjistruar nje rezultat negativ ne shumen -54,824,736 leke pasi sikurse theksuam me lart kjo shoqeri eshte shoqeri ne likujdim dhe nuk zhvillon aktivitet ekonomik.

Bashkëlidhur këtij raporti eshte bilanci i plote kontabël për vitin 2017 si dhe bilanci per vitin 2018 deri ne momentin e bashkimit .

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES - "PETROL ALBA" SH.A. TIRANE

shoqëria **"PETROL ALBA" sh.a.** ka rezultuar me një humbje tregtare në vlerën **-296,243,967** Lekë. Per vitin 2018 shoqeria ka regjistruar nje rezultat negativ ne shumen -54,824,736 leke pasi sikurse theksuam me lart kjo shoqeri eshte shoqeri ne likujdim dhe nuk zhvillon aktivitet ekonomik.

Bashkëlidhur këtij raporti eshte bilanci i plote kontabël për vitin 2017 si dhe bilanci per vitin 2018 deri ne momentin e bashkimit .

Shoqëria zbaton Standardet Kombëtare te Kontabilitetit dhe Legjislacionin Tatimor ne fuqi.

Shoqëria zbaton parimet e kontabilitetit:

- Parimin mbi bazën e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Transaksionet dhe ngjarjet e tjera ekonomike janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur. Shpenzimet janë njohur në të njëjtën periudhë kontabël që janë marrë dhe të ardhurat që iu korrespondojnë atyre.

- Parimi i njësisë ekonomike.

Në pasqyrat financiare janë regjistruar aktivet, pasivet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet, fluksi i parasë që i përkasin njësisë ekonomike.

- Parimi i moskompensimit.

Shoqëria, me përjashtim te kompensimeve qe lejon Standarti Kombëtar i Kontabilitetit, nuk ka bere kompensime midis aktiveve dhe pasiveve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

- Parimi i kostos historike.

Pasqyrat financiare janë ndërtuar mbi bazën e kostos historike, pa bere rivleresime te aktiveve dhe as te pasiveve.
Metoda e përdorur ne lidhje me koston mbi aktivet dhe pasivet aplikohet parimi i kostos historike.
Kontabiliteti mbahet i informatizuar nga persona të licencuar ne baze te kontratave te sherbimit. Organizimi i kontabilitetit mbahet ne mënyre analitike, i cili u shërben nevojave te kontrollit te performancës dhe analizave te brendshme ne mënyrë te kënaqshme.
Çdo veprim mbështet ne dokumenta ligjore justifikues dhe kontabilizohet ne afate optimale.

Metoda baze e mbajtjes se kontabilitetit është regjistrimi i dyfishtë. Te paktën një here ne vit behet vlerësimi i ekzistencës se elementeve te aktivit dhe pasivit te bilancit.

Grupet kryesore të aktivit dhe të pasivit, sipas bilancit te vitit **2018** për shoqërinë **"Petrol Alba" sh.a.** pasqyrohen si vijon:

| | |
|---|---|
| a) AKTIVET Në total | 1,946,119,577 Lekë. |
| • Aktivet afatshkurtra ne vlerën neto | 900,270,494 Lekë. |
| • Aktive afatgjata ne vlerën neto | 1,045,849,083 Lekë. |
| b) PASIVET Në total | 1,946,119,577 Lekë. |
| • Pasivet afatshkurtra ne vlerën neto | 190,441,987 Lekë. |
| • Pasivet afatgjata ne vlerën neto | 0 Lekë. |
| c) AKTIVET neto në vlerën | 1,755,677,590 Lekë. |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES - "PETROL ALBA" SH.A - TIRANE

d) Shoqëria aktualisht operon me banken:

1. Credins Bank

Bilanci dhe pasqyrat financiare mbahen ne Lekë shqiptare. Gjatë vitit nuk operohet në monedha të huaja.

Zeri **"kerkesa te arketueshme"** në vitin 2018 eshte ne nje vlere **495,658,866** Lekë, zeri istrumenta te tjera borxhi ne shumen 212,826,792 leke. Gjendja e inventarëve është në vlerën **47,545,600** Lekë.

Aktivet afatgjata materiale shprehen ne bilanc me vlerën e tyre neto (duke zbritur amortizimin). Zeri **"aktive të tjera afatgjata"** paraqitet ne bilanc me vleren **1,045,849,083** Lekë.

Ne pasiv te bilancit paraqiten te detajuara detyrimet afatshkurtra te aktivitetit me nje vlere **190,441,987** Lekë.

Kapitalet e veta shoqëria **"Petrol Alba" sh.a.** me datë **30.11.2018**

i ka në vlerën **1,755,677,590** Lekë.

Mbështetur ne te dhënat e vitit aktual, shoqeria eshte nje shoqeri ne likujdim .

2. Shoqëria **"Shperndarja e librit shkollor"** sh.a.

Shoqeria **"Shperndarja e librit shkollor" sh.a.** eshte krijuar më datë 09.05.2000.

Kapitali themeltar është në vlerën 225,452,000 (dyqindenjezeteepesemilione katerqindepedhjeteedymije) Lekë.

Kapitalet e veta shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** i ka në vlerën **– 53,708,390** lekë.

Kapitali i shoqërisë **"Shperndarja e librit shkollor" sh.a.** zotërohet 100% nga ortaku shtet Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise, qe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 100% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie

Shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor"** sh.a. eshte shoqeri ne likujdim dhe per kete arsye ka nje rezulta negativ, e shprehur kjo edhe te grupi i kapitaleve te veta e cila rezulton me minus.Shoqeria, deri me date **31.12.2018**, ka dale me nje rezultat negativ sepse eshte shoqeri ne likujdim dhe nuk zhvillon aktivitet ekonomik .

Bashkëlidhur këtij raporti janë bilancet e plota kontabël përkatëse për tre vitet e fundit ushtrimor.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES - PETROL ALBA SH.A. TIRANE

Shoqëria zbaton Standardet Kombëtare te Kontabilitetit dhe Legjislacionin Tatimor ne fuqi.

Shoqëria zbaton parimet e kontabilitetit:

- Parimin mbi bazën e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Transaksionet dhe ngjarjet e tjera ekonomike janë njohur në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur. Shpenzimet janë njohur në të njëjtën periudhë kontabël që janë marrë dhe të ardhurat që iu korrespondojnë atyre.

- Parimi i njësisë ekonomike.

Në pasqyrat financiare janë regjistruar aktivet, pasivet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet, fluksi i parasë që i përkasin njësisë ekonomike.

- Parimi i moskompensimit.

Shoqëria, me përjashtim te kompensimeve qe lejon Standarti Kombëtar i Kontabilitetit, nuk ka bere kompensime midis aktiveve dhe pasiveve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

- Parimi i kostos historike.

Pasqyrat financiare janë ndërtuar mbi bazën e kostos historike, pa bere rivleresime te aktiveve dhe as te pasiveve.

Metoda e përdorur ne lidhje me koston mbi aktivet dhe pasivet aplikohet parimi i kostos historike.

Kontabiliteti mbahet i informatizuar nga persona të licencuar ne baze te kontratave te sherbimit. Organizimi i kontabilitetit mbahet ne mënyre analitike, i cili u shërben nevojave te kontrollit te performancës dhe analizave te brendshme ne mënyrë te kënaqshme.

Çdo veprim mbështet ne dokumenta ligjore justifikues dhe kontabilizohet ne afate optimale.

Metoda baze e mbajtjes se kontabilitetit, është regjistrimi i dyfishtë. Te paktën një here ne vit behet vlerësimi i ekzistencës se elementeve te aktivit dhe pasivit te bilancit.

Grupet kryesore të aktivit dhe të pasivit, sipas bilancit te vitit **2018** për shoqërinë **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** pasqyrohen si vijon:

2. AKTIVET Në total — 14,319,725 Lekë.

- Aktivet afatshkurtra ne vlerën neto — 13,054,156 Lekë.
- Aktive afatgjata ne vlerën neto — 1,265,569 Lekë.
- Llogari jashte Bilancit — 618,528 Lekë

3. PASIVET Në total — 14,319,725 Lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES - "PETROL ALBA" SH.A. TIRANE

A/7

- Pasivet afatshkurtra ne vlerën neto 21,292,026 Lekë.
- Pasivet afatgjata ne vlerën neto 46,736,089 Lekë.
- Llogari jashte Bilancit 618,528 Lekë

4. AKTIVET neto në vlerën - 53,708,390 Lekë.

Shoqëria operon me disa banka dhe konkretisht :

i. Banka Credins
ii. Banka Raiffeisen

Bilanci dhe pasqyrat financiare mbahen ne Lekë shqiptare.

Zeri "**kerkesa te arketueshme**" në vitin 2018 eshte ne nje vlere **13,054,156** Lekë. Ne menyre analitike po paraqesim perberjen e ketij zeri si me poshte :

Ne zerin vlera kontabël e objekteve të prishura (Librari QSUT & Magazina Librazhd) ne vleren totale: 748,784 Leke. Per keto te drejta kemi hapur process gjyqesor kunder Drejtorise Q.S.U.T dhe INUK ne dt 15.12.2014. Shoqeria ne vitin 2018 ka fitur ceshtjen ne gjykate ndaj QSUT dhe eshte lidhur kontrate me permbaruesin per ekzekutimin e vendimit te gjykates, dhe paraqiten si te drejta te shoqerise per tu arketuar.

Ne zerin te drejta te arketueshme ne Shumen 28,160,357 leke, te cilat perbehen nga ish punonjes te shoqerise qe kane detyrime ndaj shoqerise dhe jane detyrimi qe ka Pellumb Domi ne shumen 7,004,966 leke, Kozeta Shtepani ne Shumen 1,648,166 leke te cilet kane kaluar ne permbarim por nuk u jane gjetur pasuri.
Aktualisht eshte ne proces Shtypshkronja At Gjergj Fishta per shumen 2,013,169 leke, Adriana Shkembi eshte mbyllur ceshtja dhe eshte lidhur kontrate me permbaruesin per shumen 7,125,031 leke, debitore ish punonjes ne vite ne shumen 3,364,186 leke, debitore ish punonjes te shoqerise te cileve u eshte derguar njoftimi dhe eshte kthyer pergjigje nga persona te panjohur, debitore per te cilet nuk egziston analiza ne Shumen 5,991,093 leke, dhe debitore ish punonjes te shoqerise te cileve nuk u eshte gjetur adresa ne Shumen 1,013,746 leke.

Shoqeria ka provigjonuar 81% te te drejtave te arketueshme ne Shumen 39,425,077 leke . Keto te drejta jane te mbartura nga bilanci i likujdimit dhe me gjithe perpjekjet e bera per arketimin e tyre nuk eshte bere e mundur. Ne shumicen e tyre jane fituar proceset gjyqsore , duke ia kaluar permbarimit ekzekutimin e vendimeve gjyqesore

dhe ne pjesen me te madhe te tyre eshte pushuar ceshtja, per mos gjetje pasurie per debitorin

Në këtë zë të pasqyrës së pozicionit financiar paraqiten tepricat e llogarive si kërkesat ndaj personelit per detyrime ndaj shoqerise lene detyre prej auditit ne Shumen 173,615 leke, si dhe teprica kreditore e llogarise, shteti tvsh e kreditueshme ne vleren 1,123,210 leke.

Në këtë zë përfshihen mallrat për rishitje (libra) ne vleren 942,350 leke.Ky inventar është i trashëguar nga bilanci i likujdimit.Këto libra shkollorë kanë dalë nga qarkullimi si rezultat i ndryshimit të kurrikulave arsimore.Nga viti 2000 nuk ka pasur shtesa duke qenë se ka pasur një kohë të gjatë qëndrimi.Ky ze perfaqeson mjetet te xhiros (libra te ndihmes se akorduar nga Qeveria Italiane ne tekste shkollore) te cilat iu dorezuan Shtepise Botuese te Teksteve Mesimore "BOTEM" sipas shkreses se MAS ne prill te 2016 dhe eshte krijuar provigjion per zhvleresimin ne Shumen – 942,350 leke .

Ne ket ze perfshihet vlera e objektit (Libraria Has) ne vleren 1,801,200. Ndryshimet ne vleren 847,570 leke nga 2017 vine si pasoje e shitjes se objektit , Libraria Shkollore Mamurras ne 2018 dhe zbritjes se vleres se saj nga llogaria AAGJM te mbajtura per shitje.

Gjendja e aktiveve afatgjata është në vlerën **1,265,569** Lekë, aktivet afatgjata materiale shprehen ne bilanc me vlerën e tyre neto (duke zbritur amortizimin).

| | |
|---|---|
| Magazina shkollore Skrapar | 16,884 leke |
| Magazina shkollore Vlore | 403,251 leke |
| Libraria Mollas | 339,322 leke |
| Libraria shkollore Kodoviat | 506,112 leke |

Ne zerin llogari jashte bilancit ne shumen 618.528 leke jane praqitur zeri i inventarirt ekonomik qe eshte mbajtur ne llogari jashte bilancit dhe qe nuk eshte bere procedura per nxjerrjen jashte perdorimit.

Ne pasiv te bilancit paraqiten te detajuara detyrimet afatshkurtra te shoqerise me nje vlere **21,292,026** Lekë dhe detyrimet afatgjata paraqiten ne bilanc me nje vlere **46,736,089** Lekë.

Në zerin detyrime afishkurtra ne vleren 21.292.026 leke janë paraqitur teprica kreditore e llogarive që pasqyrojnë detyrimet që i kanë lindur shoqërise nga:

I. **Arkëtimi i mjeteve monetare ne avance 17,612,910 leke** nga të tretët (për shitjen e objekteve të cilat nuk i janë dorëzuar bleresit pasi shoqëria është në proçes gjyqësor ne vleren:

I(a). 1.671.798 leke per objektin ne QSUT shitur me ankand por per te cilin nuk bere I mundur dorezimi i objektit prane bleresit pasi objekti eshte prishur me vendim te INUK. Procesi gjygjesor ndaj INUK dhe QSUT hapur prej shoqerise ka perfunduar tashme . Vendimi gjygjesor I ketij procesi eshte pasqyruar ne Pasqyrat Financiare te shoqerise ne zerin vlera kontabël e objekteve të prishura ne vleren totale: 748,784 Leke.

I(b). 2,256,722 leke per objektin Libraria Has.*Libraria Has* eshte shitur me ankand ne vitin 2008 por nuk eshte bere i mundur dorezimi i objektit prane bleresit, pasi ne ZVRPP te Rrethit Has ky objekt eshte rregjitruar ne pronesi te ish bankes se kursimeve ,per kete arsye shoqeria eshte ne proces gjyqesor per zgjidhjen e pronesise dhe pret ti kaloje objekti fituesit te ankandit i cili ka te ngurtesuar ne llogarine e shoqerise vleren e arritur ne ankand per kete objekt ne Shumen 2,256,722 leke.

I(c). 13,378,584 leke dhe 305,806 leke, detyrime keto per tu derdhur ne buxhetin e shtetit pasi Toka nën objekt e cila nuk është në kapitalin e shoqërise dhe arkëtimet nga shitja e saj nuk janë e ardhur për shoqërine por detyrim për t'u derdhur në buxhetin e shtetit ne shumat respektive 13,378.584 leke, si dhe arketimet nga qerate per tu derdhur ne buxhetin e shtetit ne shumen 305,806leke.

1. **Te pagushme per aktivitetin e shfryezimit ne shumen 1,139,660** leke janë paraqitur detyrimet tregtare që i kanë lindur shoqërise për, shërbimet e kryera nga te tretet, per qera, sherbime auditimi dhe plane rilevimi.

2. **Te pagueshme ndaj punonjesve ne Shumen 1,907,483** leke përfshihen tepricat kreditore të llogarive për detyrimet e shoqërise ndaj punonjësve ne shumen 403,083 leke , detyrime per paga ndaj keshillit mbikqyres ne shumen 833,340 leke, detyrimi per derdhjen e tatimit mbi page ne Shumen 40,300 leke, detyrime ndaj ish punonjesve ne Shumen 10,000 leke, per detyrim paga te fituara me gjyq ne Shumen 458,940 leke, si dhe detyrimi ndaj sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Shumen 161,820 leke që parashikohen të shlyhen brenda 12 muajve.

3. **Detyrime tatimore** ne shumen 572,460 leke janë përfshirë detyrimet që Shoqëria ka per taksen vendore 463,147 leke, si dhe detyrimin per tatimin ne burim ne shumen 109,313 leke.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES
"PETROL ALBA" SH.A TIRANE

4. **Te tjera te pagushme** ne shumen 59.513 leke eshte perfshire detyrimi i shoqerise per derdhjen e klientit A. Verria, derdhur garanci sipas kontrates se qerase per objektin Libraria Fier. Ndryshimi prej 9,487 leke nga viti i kaluar ka ardhur si rezultat i mbylljes

se detyrimit te klientit per kamtvonesa ne pagesat e qerase, lene detyre prej auditit dhe te evidentuara keto ne Pasqyrat Financiare te vitit 2017.

Në zerin detyrime afatgjata kreditoret e shoqerise **ne Shumen 32,901,734** leke janë paraqitur detyrimet tregëtare që i kanë lindur Shoqërise ndaj të tretëve për mallrat, shërbimet dhe produktet e blera por të pa paguara për periudha afatgjatë; këtu bëjnë pjesë kreditorët e shoqërise. Shoqëria ka kaluar në likujdim me 04/06/2004 detyrimet ndaj kreditorëve shlyhen në proporcion me mjetet monetare të siguruara nga shitja e aseteve në vazhdimësi. Ne zerin provizione, provizione per interesat e kreditoreve te fituara nga proceset gjyqesore ne shumen 13,834,355 leke, jane llogari te trasheguara nder vite.

Kapitalet e veta te shoqërise **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** me datë 31.12.2018 jane në vlerën **– 53,708,390** Lekë.

Mbështetur ne te dhënat e tre viteve te fundit, ekzistojnë premisat e plota që shoqëria nuk ka vazhdimesi per arsye se eshte nje shoqeri ne likujdim dhe nuk zhvillon asnje lloj aktiviteti ekonomik.Bashkelidhur ketij raporti per bashkimin me perthithje te shoqerise "Shperndarja e Librit Shkollor: sh.a me shoqerine "Petrol Alba" sha te dyja shoqeri ne likujdim jane te shpjeguar ne menyre analitike te gjithe zerat e bilancit te kesaj shoqerie.

3. Drejtimi i Bashkimit :

Ne këtë operacion bashkimi, shoqëria **"Petrol Alba " sh.a.** do te jete shoqëria përthithëse, e shënuar ne vijim si shoqëria përfituese e kontributeve dhe shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** shoqëri e përthithur, e shënuar ne vijim si shoqëria kontribuese.

4. Motivet dhe qëllimet e bashkimit.

Motivi i bashkimit të shoqërive është grupimi i forcave dhe mjeteve për minimizimin e kostove duke qene se keto shoqeri jane shoqeri ne likujdim dhe merren me administrimin e objekteve te mbetura per privatizim. Meqenëse shoqëria **"Shperndaraja e Librit Shkollor" sh.a.** mund te administrohet me mire, u mendua qe e vetmja mënyrë me e leverdishme për pronarin e vetem qe eshte shteti, është bashkimi

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES "PETROL ALBA" SH.A. TIRANE

e vetmja mënyrë me e leverdishme për pronarin e vetem qe eshte shteti, është bashkimi me shoqërinë **"Petrol Alba" sh.a.** për te shfrytëzuar me efektivitet aktivet qe ajo ka ne dispozicion, por dhe për faktin qe shoqëria përthithëse eshte shoqeri ne likujdim dhe vetem sa do te rriste kostot nga vazhdimi i funksionimit te saj. **Pra, pasojat pozitive dhe negative te shoqërise se përthithur jane nen pergjegjesine e te njejtit ortak qe perbejne edhe ortakun e vetem te shoqërisë përthithëse.**

5. Aktivet dhe pasivet (detyrimet) e parashikuara për tu transferuar.

Ne kuadër te këtij operacioni bashkimi parashikohet qe shoqëria e përthithur **"Shperndarja e Librit Shkollor"** sh.a. do te transferoje (kaloje) tek shoqëria përthithëse **"Petrol Alba" sh.a.** tërësinë e elementeve te aktivit dhe te pasivit, deri me 31.12.2018.
Bazuar ne bilancin kontabel, grupet kryesore te këtyre aktiveve dhe pasiveve, pas bashkimit janë caktuar e vlerësuar si vijon :

a) AKTIVE:

| | |
|---|---|
| • Aktivet afatshkurtra ne vlerën | 913,324,650 Lekë. |
| • Aktive afatgjata ne vlerën | 1,047,114,652 Lekë. |
| • Totali | 1,960,439,302 Lekë. |

b) PASIVE:

| | |
|---|---|
| • Pasivet afatshkurtra ne vlerën neto | 211,734,013 Lekë. |
| • Pasivet afatgjata ne vlerën neto | 46,736,099 Lekë. |
| • Totali | 258,470,102 Lekë. |

c) KAPITALI

| | |
|---|---|
| • Kapitali regjistruar | 2,877,425,000 Leke |
| • Fitime dhe rezerva | -1,175,455,800 Leke |
| • Totali | 1,701,969,200 Leke |

**Ne aspektin kontabël te gjitha transaksionet e kryera nga shoqëria e përthithur "Shperndarja e Librit shkollor" sh.a. prej dates 01.01.2019 e ne vazhdim do te regjistrohen si transaksione te shoqërisë përthithëse, pra te shoqërisë "Petrol Alba" sh.a.**

Shoqëria **"Petrol Alba"** sh.a. do te jete zotëruese e kontributit te shoqërisë **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** ne datën e realizimit përfundimtar te operacionit te bashkimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJITIKES "PETROL ALBA" SH.A TIRANË

Shoqëria **"Petrol Alba" sh.a.** gëzon frutet e kontributit te përfituar duke filluar nga data 01.01.2019 me kushtin e realizimit te bashkimit ne fjale.
Kapitali i nënshkruar mbas bashkimit është ne vlerën 2,887,425,000 Lekë , me numer aksionesh 2,887,425 dhe vlera nominale eshte 1000 Lekë dhe zotërohet nga ortaku i vetem shtet qe eshte Ministria e Finances dhe Ekonomise.
Ndaj punonjësve te shoqërise se perthithur "Shperndarja e Librit Shkollor " sha ne likujdim ne perfundim te procedurave te bashkimit, eshte bere sipas percaktimeve te kodit te punes.

6. Data kontabël

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarisë te kryera prej shoqërive "Shperndarja e Librit shkollor "**sh.a.** nga 01.01.2019 e deri ne datën e realizimit te bashkimit do te konsiderohen si te kryera nga shoqëria **"Petrol Alba" sh.a.** dhe regjistrimet kontabile do te mbahen ne librat e kësaj te fundit.

7. Data e përgatitjes (hartimit) te llogarive.

Llogaritë qe janë përdorur për te përcaktuar kushtet financiare te bashkimit janë hartuar duke iu referuar datës 30.11.2018 për shoqërinë përthithëse dhe 31.12.2018 për shoqërinë e përthithur.

Bashkëlidhur është bilanci i bashkimit te shoqërive i datës se bashkimit 31.12.2018.

Raportet e këmbimit.

Meqenëse ortaku i shoqërisë përthithëse eshte i njëjte me ortakun e shoqerise se perthithur, te drejta dhe detyrime ndaj shoqërise se përthithur nuk është e nevojshme për analiza lidhur me raportet e këmbimit te kuotave.
Kapitalin e nënshkruar te shoqërise se përthithur e zotëron 100% shoqëria përthithëse qe ka ortakun e vetem qe eshte shtet dhe eshte Ministria e Finances dhe Ekonomise dhe zoterohet si me poshte :
Ministria e Finances dhe Ekonomise, qe zoteron 1 (nje) kuote me vlere 100% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie,
Si te tilla kuotat janë vlerësuar ne nivele te njëjta me te njëjtën vlere qe është ne bilanc dhe perfaqesojne vleren e nje kuote qe i përket ortakut te shoqërisë përthithëse.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJITIKES - "PETROL ALBA" SH.A. TIRANE

8. Te drejtat dhe avantazhet e veçanta.

Ky operacion bashkimi nuk do te përmbaje si te drejta ashtu dhe ndonjë avantazh te veçante.

Ky projekt bashkimi hartohet e nënshkruhet me kushtin e varësisë se miratimit nga likujdatoret e secilës prej shoqërive pjesëmarrëse ne bashkim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "PETROL ALBA" sh.a.

LIKUJDATORI

Gentjan Dalipaj

Tirane, 17.01.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "SHPERNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" sh.a.

LIKUJDATORJA

Nermin Bardulla

RAPORT
MBI BASHKIMIN ME PËRTHITHJE
TE SHOQËRISE "SHPERNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR" SH.A. NGA SHOQËRIA
"PETROL ALBA" SH.A.

**Ortaku :**

**Ministrisë së Fanancave dhe Ekonomisë**

Ne ekzekutim të misionit qe më është besuar prej jush, kam nderin t`ju paraqes raportin mbi bashkimin e shoqërive :

- **Shoqëria përthithëse "Petrol Alba " sh.a.,** me kapital te nënshkruar 2,651,973,000 Lekë, të nënshkruar plotësisht nga ortaku, Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise.

- **Shoqëria e përthithur "Shperndaraj e Librit Shkollor" sh.a.,** me kapital te nënshkruar 225,452,000 Lekë, të nënshkruar plotësisht nga ortaku, Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise.

- **Baza ligjore**: Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare të Biznesit".
- Dokumentat ligjore e kontable të vëna në dispozicion nga shoqeritë.

## BASHKIMI I SHOQERIVE

Shoqëria **"Petrol Alba" sh.a.** dhe shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a shoqeri ne likujdim ne baze te urdherit nr. 287, date 25.10.2018 per bashkimin me shoqerine "Petrol Alba " sha ne likujdim me ane te perthithjes te shoqerise "Shperndarja e librit Shkollor" sh.a.** ne lijkudim kane bere marrëveshje për t'u bashkuar ne një shoqëri te vetme, bashkim i cili do te behet me përthithje, mbështetur në dispozitat e Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, likudatoret e shoqërive respektive përgatisin raport për të detajuar bashkimin e shoqërive për ta paraqitur këtë pranë QKB (**ortaku ish** Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise) .

### Shoqëria tregetare "Petrol Alba" sh.a.

Shoqëria "Petrol Alba" sh.a me adrese : Rruga e kavajes , Godinë e Ndërmarrjes "Industriale Nr.1", Tirane, Shqiperi, me NUIS (NIPT) K81706001T, me objekt te ushtrimit te veprimtarisë magazinimin, tregtimin me shumice dhe pakice te karburanteve dhe nenprodukteve te tyre, etj me likujdator z. Gentjan Dalipaj .
Ortaku i vetem eshte ish Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise.

Shoqëria është krijuar me 06/05/2008 me kapital themeltar 2,651,973,000 (dymilardeegjashteqindepesedhjetenjemilionenenteqindeshtatedhjeteetremije)Lekë.
Kohëzgjatja e veprimtarisë sipas aktit të themelimit dhe statutit është pa afat.

Numri i kuotave është 1 (nje) kuote dhe ortak i vetem eshte ish Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise.

**<u>Shoqëria "Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.</u>**

Shoqëria "Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a me adrese : Rruga e kavajes , Godinë e Ndërmarrjes "Industriale Nr.1", Tirane, Shqiperi, me NUIS (NIPT) J61903001V, me objekt te kryerjen e cdo operacioni tregetar dhe financiar qe lidhet drejperdrejte me objektet e saj sipas legjislacionit ne fuqi me likujdatore te shoqerise znj. Nermin Bardulla..

Ortaku i vetem eshte ish Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise .

Kapitali themeltar i shoqërisë **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** më datë 30.2.2018 është në vlerën 225,452,000 (dyqindenjezeteepesemilionekaterqindepesedhjeteedy mije) Lekë.

Numri i kuotave është 1 (nje) kuote dhe ortak i vetem eshte ish Ministria e Ekonomise , Tregetise dhe Sipermarrjes sot Ministria e Finances dhe Ekonomise.

Bazuar ne dekomentacionin e meposhtem:

- Vendimin nr 287, date 25.10.2018 **date 25.10.2018 per bashkimin me shoqerine "Petrol Alba " sha ne likujdim me ane te perthithjes te shoqerise "Shperndarja e librit Shkollor" sh.a.** dhe emerimin e ekspertit kontabel.
- Projekt-Marreveshjes per bashkimin me përthithje të shoqërise **"Shperndarja e librit Shkollor " sha.** nga shoqëria **"Petrol Alba" sh.a.** të datës 31.12.2018.
- Bilancet kontable te dy shoqerive objekt bashkimi te dates 31.12.2018.

Mbi bazen e ketyre dokumentave ligjore u krye analiza per secilin shoqeri dhe kryerja e modaliteteve per kushtet ligjore e financiare te ketij bashkimi.

Sa me siper rezulton se mbi bazen e bilanceve kontable qe kane hartuar shoqerite, bilance te cilat u verifikuan nga ana ime si ekspert, duke u mbeshtetur ne normat e profesionit, rezulton gjendja si vijon :

# Bilanci -BASHKIMIT ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE 31.12.2018

| A | AKTIVI | Shënime | Viti raportues 30.11.2018, PETROL ALBA | Viti raportues 31.12.2018, LIBRI SHKOLLOR | BILANCI I BASHKIMIT 31.12.2018 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| I | AKTIVET AFATSHKURTRA | | | | |
| 1 | **Aktive monetare** | | 144,239,236 | 5,361 | 144,244,597 |
| 2 | Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim | | - | | |
| | (i) Derivativët | | - | | |
| | (ii) Aktivet e mbajtura për tregtim | | - | | |
| | **Totali 2** | | **144,239,236** | **5,361** | **144,244,597** |
| 3 | **Aktive të tjera financiare afatshkurtra** | | | | |
| | (i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme | | 390,656,127 | 21,252 | 390,677,379 |
| | Vlera kontabel e objekteve te prishura | | | 748,784 | 748,784 |
| | Ish punonjes te shoqerise | | | 28,160,357 | 28,160,357 |
| | Persona te tjere qe kane pasur mardh. Tregtare me shoqerine | | | 20,445,454 | 20,445,454 |
| | (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme | | 105,002,739 | | 105,002,739 |
| | Zhvlersimi I te drejtave dhe detyrimeve | | | (39,425,077) | (39,425,077) |
| | (iii) Instrumente të tjera borxhi | | 212,826,792 | 1,296,825 | 214,123,617 |
| | (iv) Investime të tjera financiare | | - | | |
| | **Totali 3** | | **708,485,658** | **11,247,595** | **719,733,253** |
| 4 | **Inventari** | | | | |
| | (i) Lëndët e para | | 43,906,404 | | 43,906,404 |
| | (ii) Prodhim në proces | | - | | |
| | (iii) Produkte të gatshme | | - | | |
| | (iv) Mallra për rishitje | | 3,639,196 | 942,350 | 4,581,546 |
| | (v) Parapagesat për furnizime | | | | |
| | Zvleresimi I inventarit | | | (942,350) | (942,350) |
| | **Totali 4** | | **47,545,600** | - | **47,545,600** |
| 5 | **Aktivet biologjike afatshkurtra** | | - | | |
| 6 | **Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje** | | | 1,801,200 | 1,801,200 |
| 7 | **Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | | | | |
| | | | | | |
| | TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I) | | 900,270,494.08 | 13,054,156.00 | 913,324,650.08 |
| | | | | | |
| II | AKTIVET AFATGJATA | | | | |
| 1 | **Investimet financiare afatgjata** | | | | |
| | (i) Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm në PF) | | - | | |
| | (ii) Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje | | - | | |
| | (iii) Aksione dhe letra të tjera me vlerë | | - | | |
| | (iv) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata | | - | | |
| | **Totali 1.** | | - | | |
| 2 | **Aktive afatgjata materiale** | | | | |
| | (i) Toka | | 814,525,887 | | 814,525,887 |
| | (ii) Ndërtesa | | 226,687,664 | 1,265,569 | 227,953,233 |
| | (iii) Makineri dhe pajisje | | 3,634,635 | | 3,634,635 |
| | (iv) Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.) | | 1,000,897 | | 1,000,897 |
| | **Totali 2** | | **1,045,849,083** | **1,265,569** | **1,047,114,652** |
| 3 | **Aktivet Biologjike afatgjata** | | - | | |
| 4 | **Aktivet afatgjata jomateriale** | | | | |
| | (i) Emri i mirë | | - | | |
| | (ii) Shpenzimet e zhvillimit | | - | | |
| | (iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale | | - | | |
| | **Totali 4** | | - | | |
| 5 | Kapital aksionar i papaguar | | - | | |
| 6 | Aktive të tjera afatgjata | | - | | |
| | TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II) | | 1,045,849,083 | **1,265,569** | **1,047,114,652** |
| | TOTALI I AKTIVEVE (I + II) | | 1,946,119,577 | **14,319,725** | **1,960,439,302** |
| | **Llogari jasht bilancit** | | | **618,528** | **618,528** |
| | TOTALI I AKTIVEVE (I + II+III) | | 1,946,119,577 | 14,938,253 | 1,961,057,830 |

| B | PASIVI | Shënime | Viti raportues 30.11.2018, PETROL ALBA | Viti raportues 31.12.2018, LIBRI SHKOLLOR | BILANCI I BASHKIMIT 31.12.2018 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | DETYRIMET DHE KAPITALI | | | | |
| I | DETYRIMET AFATSHKURTRA | | | | |
| 1 | **Derivativët** | | - | | |
| 2 | **Huamarrjet** | | | | |
| | (i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra | | - | | |
| | (ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata | | - | | |
| | Arktime ne avance | | | 17,612,910 | 17,612,910 |
| | **Totali 2** | | - | **17,612,910** | **17,612,910** |
| 3 | **Huatë dhe parapagimet** | | | | |
| | (i) Të pagueshme ndaj furnitorëve | | 43,557,131 | 1,139,660 | 44,696,791 |
| | (ii) Të pagueshme ndaj punonjësve | | 8,242,737 | 1,907,483 | 10,150,220 |
| | (iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore | | 865,843 | 631,973 | 1,497,816 |
| | (iv) Hua të tjera | | 137,776,276 | | 137,776,276 |
| | (v) Parapagimet e arkëtuara | | - | | |
| | Totali 3 | | **190,441,987** | **3,679,116** | **194,121,103** |
| 4 | **Grantet dhe të ardhurat e shtyra** | | - | | |
| 5 | **Provizionet afatshkurtra** | | - | | |
| | | | | | |
| | TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I) | | 190,441,987 | 21,292,026 | 211,734,013 |
| | | | | | |
| II | DETYRIME AFATGJATA | | | | |
| | | | | | |
| 1 | **Huatë afatgjata** | | | | |
| | (i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare | | - | | |
| | (ii) Bonot e konvertueshme | | - | | |
| | **Totali 1** | | - | | |
| 2 | **Huamarrje të tjera afatgjata** | | | 32,901,734 | 32,901,734 |
| 3 | **Provizionet afatgjata** | | | 13,834,355 | 13,834,355 |
| 4 | **Grantet dhe të ardhurat e shtyra** | | - | | |
| | | | - | | |
| | TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II) | | - | **46,736,089** | **46,736,089** |
| | | | | | |
| | TOTALI I DETYRIMEVE | | 190,441,987 | 68,028,115 | 258,470,102 |
| III | KAPITALI | | | | |
| 1 | Aksionet e pakicës ( përdoret vetëm në pasqyrat financiare të konsolidu | | - | | |
| 2 | Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëm në P | | - | | |
| 3 | Kapitali i rregjistruar(aksionar) | | 2,651,973,000 | 225,452,000 | 2,877,425,000 |
| 4 | Primi i aksionit | | | 7,615,272 | 7,615,272 |
| 5 | Njësitë ose aksionet e thesarit (negative) | | - | | |
| 6 | Rezerva statutore | | 9,533,908 | | 9,533,908 |
| 7 | Rezerva rivleresimi | | | 1,710,890 | 1,710,890 |
| | Rezerva ligjore | | | 9,589,211 | 9,589,211 |
| 8 | Rezerva të tjera | | 181,680 | | 181,680 |
| 9 | Fitimet(humbja) e pashpërndara | | (851,186,262) | (295,980,437) | (1,147,166,699) |
| 10 | Fitimi (humbja) e vitit financiar | | (54,824,736) | (2,095,326) | (56,920,062) |
| | TOTALI I KAPITALIT (III) | | 1,755,677,590 | (53,708,390) | 1,701,969,200 |
| | | | | | |
| | TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III) | | 1,946,119,577 | 14,319,725 | 1,960,439,302 |
| | Llogari jasht bilancit | | | 618,528 | 618,528 |
| | TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III,IV) | | 1,946,119,577 | 14,938,253 | 1,961,057,830 |

## A- PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

| | Përshkrimi i Elementëve | Shënime | Viti raportues 30.11.2018, PETROL ALBA | Viti raportues 31.12.2018, LIBRI SHKOLLOR | BILANCI I BASHKIMIT 31.12.2018 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shitjet neto | | | 58,605 | 58,605 |
| 2 | Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Puna e kryer | . | 115,611,831 | 4,250,598 | 119,862,429 |
| 3 | Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhin | . | - | | |
| 4 | Materialet dhe mallrat e konsumuara | | - | (24,000) | (24,000) |
| 5 | Kosto e punës | | | | |
| | Pagat e personelit | | (27,990,938) | (2,469,737) | (30,460,675) |
| | Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore | | (4,360,197) | (394,633) | (4,754,830) |
| 6 | Amortizimet dhe zhvlerësimet | | - | | |
| 7 | Shpenzime të tjera | | (138,085,431) | (3,517,471) | (141,602,902) |
| 8 | **Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)** | | **(170,436,566)** | **(6,405,841)** | **(176,842,407)** |
| | | | | | |
| 9 | **Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)** | | **(54,824,736)** | **(2,096,638)** | **(56,921,374)** |
| | | | | | |
| 10 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara | | - | | |
| 11 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet | | - | | |
| 12 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare | | - | | |
| | 12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjer | | - | | |
| | 12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667 | | | 1,312 | 1,312 |
| | 12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669 | | | | |
| | 12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668 | | | | |
| 13 | Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/- | | - | | |
| | | | | | |
| 14 | **Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)** | | **(54,824,736)** | **(2,095,326)** | **(56,920,062)** |
| | | | | | |
| 15 | **Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69** | | | | |
| | | | | | |
| 16 | **Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)** | | **(54,824,736)** | **(2,095,326.00)** | **(56,920,062)** |
| | | | | | |
| 17 | **Elementët e pasqyrave të konsoliduara** | | - | | |

| Pasqyra e fluksit monetar – Metoda idnirekte | Shenime | Viti raportues 30.11.2018, PETROL ALBA | Viti raportues 31.12.2018, LIBRI SHKOLLOR | BILANCI I BASHKIMIT 31.12.2018 |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| *Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit* | | | | |
| Fitimi para tatimit | | (54,824,736) | (2,095,326) | (56,920,062) |
| Rregullime për: | | | | |
| Amortizimin | | | | |
| Humbje nga këmbimet valutore | | 0 | | |
| Të ardhura nga investimet(Vlera e AAM-ve te shitura) | | (18,266,762) | 37,145 | (18,229,617) |
| Shpenzime për interesa | | | | |
| Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivitet | | 5,927,145 | 230,367 | 6,157,512 |
| Rritje/rënie në tepricën inventarit | | (158,325) | 847,570 | 689,245 |
| Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti | | (1,221,857) | 982,398 | (239,459) |
| **Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet** | | **(68,544,534)** | **2,154** | **(68,542,380)** |
| Interesi i paguar | | 0 | | |
| Tatim mbi fitimin i paguar | | 0 | | |
| *Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit* | | **(68,544,534)** | **2,154** | **(68,542,380)** |
| | | | | |
| *Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese* | | | | |
| Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara | | | | |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale | | (28,708) | | (28,708) |
| Të ardhura nga shitja e pajisjeve | | 114,512,000 | 0 | 114,512,000 |
| Interesi i arkëtuar | | | | |
| Dividendët e arkëtuar | | | | |
| *Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese* | | **114,483,292** | **0** | **114,483,292** |
| | | | | |
| *Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare* | | | | |
| Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner | | 0 | | |
| Hyrje nga huamarrje afatgjata | | | | |
| Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare | | | | |
| Dividendët e paguar | | | | |
| *Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare* | | | | |
| | | 45,938,758 | 2,154 | 45,940,912 |
| *Rritja/rënia neto e mjeteve monetare* | | **45,938,758** | **2,154** | **45,940,912** |
| | | | | |
| *Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël* | | **98,300,478** | **3,207** | **98,303,685** |
| *Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël* | | **144,239,236** | **5,361** | **144,244,597** |

Sipas pasqyres së mësiperme shoqëritë kane zbatuar kushtet ligjore për bashkimin e tyre sepse;

Te dy shoqerite kane percaktuar modalitetet e ketij bashkimi.
Kane percaktuar datën e bashkimit dhe kanë nxjerrë bilancet financiare të plota deri në datën 31.12.2018 per shoqerine **"Shperndarja e Librit Shkollor"sh.a.**, dhe 30.11.2018 per "Petrol Alba " sha.

U krye analiza e këtyre bilanceve.

Pas përfundimit të këtij operacioni bashkimi që kryen shoqeritë tuaja, hartohet ky raport që saktëson gjendjen kontable të këtij bashkimi :

1. Drejtimi i Bashkimit:

Ne këtë operacion bashkimi shoqëria **"Petro Alba"sh.a.** qe do te jete shoqëria përthithëse, e shënuar ne vijim si shoqëria përfituese e kontributeve dhe shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a.** shoqëri e përthithura, te shënuara ne vijim si shoqëri kontribuese.

2. Motivet dhe qëllimet e bashkimit.

Motivi i bashkimit të shoqërive është se duke qene se keto dy shoqeri jane ne likujdim dhe nuk zhvillojne aktivitet te mirefillte ekonomik. Meqenëse shoqëria **"Shperndarja e Librit Shkollor"sh.a.**, , zoterues te kapitaleve ka te njejtin ortak qe ka dhe shoqeria qe do ta perthith, u mendua qe eshte me e leverdishme për pronarin bashkimi i tyre ne menyre qe te miminizohen kostot e teperta qe behen .

3. Aktivet dhe pasivet (detyrimet) e parashikuara për tu transferuar.

Ne kuadër te këtij operacioni bashkimi, parashikohet qe shoqëria e përthithura **"Shperndaraj e Librit Shkollor "sh.a.** do te transferojne (kalojne) tek shoqëria përthithëse **"Petrol Alba"sh.a.** tërësinë e elementeve te aktivit dhe te pasivit, duke përfshirë edhe ato qe rezultojnë nga operacionet e kryera qe nga data 31.12.2018.

**Ne aspektin kontabël, te gjitha transaksionet e kryera nga shoqëria e përthithur "Shperndaraj e Librit Shkollor"sh.a. qe nga data 31.12.2018 e ne vazhdim do te regjistrohen si transaksione te shoqërisë përthithëse, pra te shoqërisë "Petrol Alba"sh.a.**

Shoqëria **"Petrol Alba"sh.a.,** do te jete zotëruese e kontributit te shoqerise **"Shperndaraj e Librit Shkollor "sh.a** ne datën e realizimit përfundimtar te operacionit te bashkimit.

Shoqëria **"Petrol Alba"sh.a.** gëzon frutat e kontributit te përfituar duke filluar nga data 31.12.2018 me kushtin e realizimit te bashkimit ne fjale.

***Kapitali i nënshkruar mbas bashkimit është ne vlerën 2,877,425,000 (dy miliardeeteteqindeshatedhjeteeshtatemilione katerqindenjezeteepesemije) Lekë e cila perfaqeson nj (nje) kuote me vleren totale 2,877,425,000 (dy miliardeeteteqindeshatedhjeteeshtatemilione katerqindenjezeteepesemije) Lekë dhe zotërohet nga ortaku si ne vijim,***

***Ministria e Finances dhe Ekonomise 1 (nje) kuote, me vlere 2,877,425,000 (dy miliardeeteteqindeshatedhjeteeshtatemilione katerqindenjezeteepesemije) Lekë.***

Ndaj punonjësve te dy shoqërive pasojat e bashkimit janë te pa konsiderueshme pasi ne urdhein me nr. 287, date 25.10.2018 te ish Ministrit te Financave dhe Ekonomise ne piken 6 eshte shprehur se perfundimi i marredhenieve te punes per punonjesit e shoqerise "Shperndarja e Librit Shkollor" sh.a shoqeri ne likujdim , ne perfundim te procedurave te bashkimit, rregullimi i marredhenieve te behet sipas percaktimeve te kodit te punes, gje e cila eshte marre parasysh gjate kryerjes se ketij bashkimi me perthithje.

Data kontabël : Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarisë te kryera prej shoqërisë **"Shperndarja e Librit shkollor " sh.a.** nga 31.12.2018 e deri ne datën e realizimit te bashkimit do te konsiderohen si te kryera nga shoqëria **"Petrol Alba" sh.a.** dhe regjistrimet kontabile do te mbahen ne librat e kësaj te fundit.

Data e përgatitjes (hartimit) te llogarive : Llogaritë qe janë përdorur për te përcaktuar kushtet financiare te bashkimit janë hartuar duke iu referuar datës 30.11.2018 për shoqërinë përthithëse dhe 31.12.2018 për shoqërine e përthithur.

*Bashkëlidhur është bilanci i bashkimit te shoqërive i datës se bashkimit 31.12.2018. Theksoj se gjate kryerjes se procedures se bashkimit me perthithje te shoqerise se perthithur "Shperndarja e Librit Shkollor" sha nga shoqeria perthithese "Petrol Alba" sha u konstatua nga ana jone se ne inventarin e aseteve te kesaj shoqerie nuk eshte e perfshire nje siperfaqe trualli qe ndodhet ne zonen kadastrale 8240 me siperfaqe 1212.88 $m^2$, 198 $m^2$, 468 $m^2$, si dhe nje ndertese me siperfaqe 57 $m^2$.*

Raportet e këmbimit : Meqenëse ortaku i shoqërisë përthithëse eshte i njëjtë dhe me te njëjtat te drejta dhe detyrime ndaj shoqërise te përthithura nuk është e nevojshme për analiza lidhur me raportet e këmbimit te kuotave pasi kapitalin e nënshkruar te shoqërisë se përthithur e zotëron 100% shoqëria përthithëse qe ka për ortake te vetem Ministrine e Finances dhe Ekonomise, si te tilla janë vlerësuar ne nivele te njëjta me te njëjtën vlere qe është ne bilanc dhe perfaqesojne nje kuot qe i përkasin oretakut te shoqërisë përthithëse.

Te drejtat dhe avantazhet e veçanta : Ky operacion bashkimi nuk do te përmbaje si te drejta ashtu dhe ndonjë avantazh te veçante.

Ky projekt bashkimi hartohet e nënshkruhet me kushtin e varësisë se miratimit nga keshillli mbikqyres i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse ne bashkim, qe ne fakt pronarin e kane te njejte dhe eshte shteti.
Ne perfundim te misionit qe me eshte caktuar prej jush, duke kryer te gjitha ekzaminimet e nevojshme, raportoj se e kam plotesuar kete detyre sipas kerkesave te ligjit.

***Sipas opinionit tim, jane zbatuar te gjitha kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "per Qendren Kombetare te Regjistrimit" per bashkimin e shoqerive me perthithje.***

Bashkelidhur ketij raporti ekspertimi kontabel, për bashkimin e shoqerive është :

- Bilanci i shoqërisë **"Petrol Alba" sh.a.** deri me 30.11.2018
- Bilanci i shoqërisë **"Shpërndarja e Librit Shkollor" sh.a.** deri me 31.12.2018
- Bilanci i konsoliduar i shoqërisë **"Petrol Alba" sh.a.** pas bashkimit të shoqerive.

Tiranë, më 17.01.2018

**Auditusja Ligjore**
**Vullnetare Çela**
**Licenca Nr 153, date 31.03.2006**